



Për: Nënkyetarën e Komunës z. Marigona Lahu

Nga: Njësiti për të Drejtat e Njeriut-NJDNJ

Raport Vjetor i Punës 2022:

Fillimisht ju informoim se Njësiti për të Drejtat e Njeriut funksionon në kuadër të organogramit organizativ si zyre e Kryetarit të Komunës ku përbëhet nga tre zyrtar me funksione përkatëse si:

-Ahmet Ahmeti- Kordinator i Njësitet për të Drejtat e Njeriut

-Naime Podvorica – Zyrtare për Barazi Gjinore

-Sali Hoxha- Zyrtar për të Drejtat e Femive

Njësiti për të Drejtat e Njeriut me kërkesën e Kryetarit të Komunës z. Shpejtim Bulliqi ka bërë raportimin favor çdo fund javë ditën e premte, por pasi që ishe kërkesa juaj për raportim atëher do të keni raportin vjetor për vitin që e lamë pas.

Njësiti për të Drejtat e Njeriut-NJDNJ, gjatë kësaj javë

Është angazhuar në disa aktivitete për ti realizuar.

Është përfunduar dhe dorëzuar raporti për vitin 2021 në MAPL me të gjitha shtyllat e plotësuara. Zyrtari për të drejtat e fëmijëve ka vazhduar kompletimin e listës së nxënësve në shkollat fillore të mesme të ulët për komunitetet RAE, është vizituar shkolla Luigj Gurakuqi në Batllavë, Orllan Zahir Pajaziti dhe në Sfeqël në shkollën Ali Ajeti.

Është vizituar zyra për ndihmë juridike falas ku është biseduar lidhur me numrin e kërkesave të parashtruara në këtë zyrë, për ndihmën juridike që ofron kjo zyrë për rastet e shumta të kërkesave në skemat sociale që ankohen shfrytezuesit e tyre si dhe çështje tjera të kësaj natyre.

Është vazhduar me punët e parapara me objektivat e planikuara.

Zyra për Barazi Gjinore-ZBGJ, është duke vazhduar me aktivitetet në koordinim me OJQ”Aureola”.

Me trajnimin e asambleisteve që kan fituar ulëse në Kuvendin Komunal të Podujevës, në zgjedhjet lokale.Njësiti për të Drejtat e Njeriut-NJDNJ, ka vazhduar me fushatën ,16- Dité Aktivizëm kundër Dhunës në Baza Gjinore .

U mbajtë takimi sensibilizues me bashkëbisedim interaktiv, është organizuar dhe realizuar në Shkollën e Mesme „Aleksandër Xhuvani” .

Nga drejtoria e shkollës ishin përzgjedhur 40- nxënës , ndërsa në panelin e punës ishin : Naime Podvorica-ZBGJ,Ahmet Ahmeti-Koordinator NJDNJ,Esat Ejupi –Konsulent, si dhe Agim Veliu Zyrtar nga QPS.

Zyrtari për të Drejtat e Fëmijëve, ka realizuar një aktivitet pune në Shkollën Fillore SHFMU,,Shaban Shala “ dhe „Naim Frashëri” . Ne fokus të punës ka qenë verifikimi i numrit të nxënësve te komunitetit pakicë, romë, ashkali e egjiptian, struktura e tyre gjinore, mosha , vijueshmëria e tyre në procesin edukativo-arsimorë, si dhe vështirësitë e tyre eventuale.

Njësiti për të Drejtat e Njeriut-NJDNJ, përveq punëve dhe angazhimeve të përditshme në zyrë, kemi pasur edhe aktivitete të tjera në përbushjen e detyrave dhe përgjegjësive në zbatimin e tyre.

Më datat: 21 dhe 22 Shkurt (e hënë dhe e marte) 2022, është mbajtur një trajnim me temën:

“Punëtoria për Manualin për menaxhimin e rrezikut”, i cili ka të bëjë me të kthyerit, për riintegrin e tyre, trajtimin dhe mbrojtjen e të drejtave të tyre, në të cilën kemi marrë pjesë, përfaqësuesi i NJDNJ-së, z. Esat Ejupi .

Është organizuar punëtori dy ditore më: 24 dhe 25 Shkurt 2022, nga PARTNERS KOSOVA me temën “Gratë ndërtojnë besim përmes komunikimit dhe riintegrimit” në të cilën ka marrë pjesë Zyrtarja për Barazi Gjinore, Znj. Naime Podvorica- NJDNJ.

Zyrtari për të Drejtat e Fëmijëve, z. Salih Hoxha , ka vizituari tri (3) nga qerdhet përfshirë të Komunës së Podujevës. Vizita ka patur qëllim shikimin e gjendjes së fëmijëve, hapësirat e objektit, pastërtia, lojëratë e të tjera. Poashtu edhe numrin e përgjithshëm të fëmijëve sipas kategorizimit në grupëmosha.

Me theks të veqant ishte gjendja e tyre përkitazi me Pandeminë Covid-19.

DEMOS , ka organizuar punëtori më 25 Shkurt 2022 (e premtë) me temën “Rritja e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimmarrje”, përfshirja e komuniteteve, pjesëmarrja e grave në proceset e konsultimit dhe vendimmarrjes, në të cilën po merr pjesë Koordinatori i NJDNJ-së z. Ahmet Ahmeti.

Njësiti për të Drejtat e Njeriut ka vazhduar me aktivitete të rregullta të punës të paraparë me planin e punës:

Zyrtarja për barazi gjinore ka mbajtur takim ne emër të rrjetit të grave Demokracia fillon këtu duke nxitur një fushatë përfshirë pjesëmarrjen e gruas në jetën publike dhe trupat nën komunale.

Duke vlerësuar dhe përgjegjësinë që kanë si zyrare për barazi gjinore në komunën e Podujevës ndarja e planeve dhe projekteve përfshirë avancimin e gjendjen së përfaqësimit të gruas , do ti shërbente ky diskutim që i kushtohet avancimit të barazisë gjinore.

-Aktivitet i organizuar nga Partners Kosova me temën Gratë thyejnë heshtjen – ndyshojnë narrativën.

Synim i kësaj tyeze ishte identifikimi i modeleve të mira përfshirë riintegrin të lehtë të grave të marginalizuara të kthyera në Kosovë nga zonat e luftës nga Siria në zhvillimet shoqërore përmes përvojave të përbashkëta të aplikuara në vendet fqinje (Maqedonia e veriut dhe Shqipëria) duke synuar që përmes rekomandimeve të hartojmë një model të zbatueshëm, dobishëm përfshirë riintegrin më të lehtë të grave të kthyera në Kosovë

Njësiti për të Drejtat e Njeriut ka vazhduar me aktivitete të rregullta të punës të paraparë me planin e punës:

Kordinatori i njesitit per te drejtat e njeriut ka bere hartimin e raportit gjashtë mujor që kerkohet nga raportimi i rregullte ne MAPL, ky raport i ka perfshire te gjitha punet, detyrat dhe angazhimet e Komunës që dalin nga përgjegjësia e ngritisë së efikasitetit të shërbimeve përfshirë qytetarët në fushat e përgjitheshme.

Raporti përban statistika, pasqyra të punës , rastet e dhunës në familje etj.

Ne bashkupunim me Kryetarin e OJQ ne Podujevë Idriz Hoxha eshte realizuar takimi me nënkyetaren e Komunes Marigona Lahu e ku në takim ishe e pranishmen edhe shefja e kabinetit te kryetarit Edona Qitaku, u diskutua rreth mundesis se hartimit te kalendarit te punës per avansimin te pozites se personave me nevoja te veqanta ne perfshirjen e tyre ne punë sipas kuotes te parapar me ligj si dhe mundesin që te kene perfaqësim dhe shkollime adekuat konform tregut te punës, ky takim i ka parapri vendimi i Kryeministrit te Kosovës që viti 2022

te jetë vit i avansimit te pozites te personave me nevoja te veqanta dhe perfshirjes se tyre sa ma te madhe ne institucionet e vendit ne te gjitha nivelet.

Njesiti per te drejtat e njeriut ka vazhduar me aktivitetet rregullat e punes.

Kordinatori i njesit per te drejtat e njeriut ka realizuar një takim ne QPS per qeshtjen e realizimit te te drejtave ne sekat sociale per disa kategori, per veshterit edhe qeshtje te tjera qe lidhen me kategori te caktuara per realizimin e te drejtave te caktuara te skemave sociale.

Zyrtarja per barazi gjinore ka pasur një aktivitet ne pregaditjen, gjegjisht ne organizimin e panairit te Grave organizuar nga OJQ (NGO-LADY) qe u mbajt ne kuader te aktiviteteve Ditet e Diaspores, me ftesat qe ka bere disa pjesmarresve per ti ekspozuar produktet e tyre qe ato zhvilloin biznesin e tyre.

Kordinatori i njesit per te drejtat e njeriut ka ralizuar edhe një takim pune me agjensionin per punesim ku jane diskutuar qeshtjet qe kan te bejne me ralizimin e projekteve per aftesimin edhe riaftesimin e te rinjeve per tregun e punes qe ata te jene konkurrent sa ma ta denje edhe te pregaditur per punsim.

Njësiti për të Drejtat e Njeriut ka vazhduar me aktivitete të rregullta të punës të paraparë me planin e punës: Kemi mare pjese ne modululin e tret te trajnimit per arsimin gjithperfshires duke integruar edhe grupet me te marginonalizuara ne procesin shkollor, ky modul ka perfshir aktivitete dhe metoda te aplikueshme per keto kategori siq jane,

Aftësitë – pjesëmarrja efektive (e të gjithëve duke përfshirë edhe përfituesit, nxënësit), bashkëpunimi (përfshirë aftësitë për zgjedhjen e konflikteve) dhe komunikimi (përfshirë aftësinë e të dëgjuarit, vëzhgimit, ndjeshmërisë, fleksibilitetit dhe përshtatshmërisë, aftësi shumëjuhësore.

Synimet e Strategisë të Kosovës në fushën e arsimit cilësor dhe gjithëpërfshirës. Sigurimi në praktikë i këtyre synimeve. Komuna jonë ka hartuar Planin e Veprimit për Integrin e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas 2021-2025. Disa nga para-fushat që trajtohen në këtë Plan të Veprimit: Arsimi, shëndetësia, punësimi, mirëqenia sociale, banimi, infrastruktura, mediat, kultura, rinia e sporti. ZKKK-ja diskutoi dhe paraqiti Planin e Zbatimit në fushën e arsimit:

Qëllimi: Ndërtimi i sistemit arsimor cilësor dhe gjithëpërfshirës të bazuar në drejtësi, barazi dhe respekt për diversitetin që i kontribuon integrimit të plotë të komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptas në shoqëri. Tema ishte: Motivimi për pjesëmarrje të shtuar në arsim. Veprimet: Organizimi i fushatës së ndërgjegjësimit për prindër për regjistrimin me kohë të fëmijëve në shkollë. Masat për mosrespektim të Ligjit mbi shkollimin e obliguar. Veprimi: Identifikohen nxënësit që kanë braktisur shkollën dhe që nuk vijojnë shkollën rregullisht. Organizohen takime informative me komunitete në lidhje me detyrimet ligjore mbi arsimin e obliguar. Kemi vazhduar me perkrahjen ne mbeshtetje te OJQ-Hendikos ne Podujevë duke siguruar materiale të nevoishme për mbështet kërkësën e tyre për forminin e komuniteti me nevoja të veqanta si trup funksional i Kuvendit. Në kuadër të fushatës kundër diskriminimit përmundësi të barabarta është përkrah projekti nga Kryetari i Komunës më vlerë 200 euro, ku në kordinim me shoqatë e HENDIKOS- Podujevë janë përzgjedhë 10 persona me nevoja të veqanta dhe janë angazhuar me punë një ditore në administratën e Komunës, me meditje nga 20 euro për person.

Në kuadër të fushatës një mujore kundë trafikimit me qenje njerëzore NJDNJ, organizuar hapjen e fushatë me datë-18.10.2022, me akterët relevant të mekanizmit kundër dhunës në familje si

dhe pëfaqësuest e shkollave etj. Fushata është vazhduar me ligjeratat që është mbajtur nëpër shkollat e mesme dhe në disa shkolla fillore SHFMU të Komunës sonë, nér këto ligjerata ka mare pjesë edhe Drejtori Ekzekutiv i OJQ-AKTI nga Komuna e FushKosovës z.Rexhep Gojnofci ekspert dhe konsulent Qeveritar i sponozorizuar për këtë projekt nga GIZI- Gjerman, krahas Drejtorit në ligjerata kanë qenë të angazhuar edhe z.Ahmet Ahmeti, znj. Naime Podvorica si dhe nga QPS z. Naim Potoku dhe znj. Selvete Shabani.

Në kuadër të fushatës 16 ditë Aktivizëm kundër dhunës në baza gjinore është realizuar projekt edhe në Komunën tone ku është bërë promovimin i fushatës se sallën e Kuvendit të Komunës, është përkrah financiarisht nga Kryetar i Komunës në vlerë 200 euro me të cilat janë siguruar materiale idetifikuese për këtë fushatë si dhe janë realizuar disa postere dhe pano me sloganet që e kanë përcjell fushatën.

NJDNJ kanë marë pjesë dhe ka kordinuar mekanizmin kundër dhunës në familje zyrtarja për Barazi Gjinore dhe antari tjetër me akterët e mekanizmit për të shqyrta rastin e një dhune në familje ku viktima është kërcnuar dhe shantazhuar nga bashkshorti i cili është duke e vuajtur denimin dhe për këtë rast mekanizmi i ka ndërmarr veprimet e nevoishme ligjore për ta mbrojtur viktimin e dhunës.

Janë realizuar edhe shumë trajnime në vinin që e lame pas si:

- Menaxhimi dhe identifikimi i dhunës ne familje.
- Identifikimi i rasteve të trafikimit.

Kemi mare pjesë edhe në debate të ndryshme me publikun siq është rasti i ndërtimi i kolektorit të ujравë të zeza për fshatrat Gërdoc- Bellopojë- Lluzhanë.

Në kuadër të punëve shtesë kemi kordinuar edhe monitoruar mbrojtën e të dhënave personale ku me agjensionin përkatës kemi mbajtur raport të punës, kemi pasur edhe vizit të punës në Komunën tone si dhe kemi marrë pjes në konferencën e agjensis në ditën për transparencën institucionale.

NJDNJ u angazhua edhe në formimin e ekipeve për mbojtjës së drejtës së fëmis që buron nga ligji për mbojtjën e fëmijeve 2019, për të cilin aktivitet jeni të informuar edhe ju, por ky ekip ende nuk është konstitue.

Podujevë

Kodrinatori i Njësitet për të Drejtat e Njeriut

Data: 06.01.2023

Ahmet Ahmeti



Nr Porotokolit: 02-401/04-0001792/22